

VENDIM
Nr.641, datë 18.9.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.665, DATË 18.12.2002 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC
PËR MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil shqiptar”, të ligjit nr.7928, datë 28.5.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.665, datë 18.12.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Vlera e TVSH-së dhe taksat doganore nuk janë të përfshira në vlerën e kontratës. TVSH-ja dhe taksat doganore të paguhen nga blerësi, pas dorëzimit të faturës për shërbime të diferencuara.”

2. Pas pikës 2, shtrohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1 Lejimin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror sh.a., që, për fondin prej 29 682 807 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatë) dollarë, të vazhdojë përdorimin e procedurës “Prokurimi i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë ndërkombëtare Lockheed Martin Global Inc, për zbatimin e fazës së dytë, në përputhje me projektkontratën e miratuar në pikën 1 të vendimit.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Vlefshmëria e kontratës për zbatimin e fazës së dytë të projektit është e lidhur dhe do të zbatohet, në përputhje me burimet financiare që zotëron ANTA sh.a., të cilat janë të pasqyruara në planbiznesin e shoqërisë, deri në çastin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes financiare të kredisë për këtë qëllim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano